POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit
1 'Ma kanë sharë shumë fustanin e nusërisë', Armina Mevlani tregon arsyen përse e zgjodhi
2 Lufta në Ukrainë/ New York Times publikon përgjimet e ushtarëve rusë me të afërmit: Putini është i çmendur
3 U arrestua në Kolumbi, 'Gucci' shqiptar dyshohet se ka gisht në zhdukjen e këngëtarit nga Elbasani! Çfarë zbuloi 'Pa Gjurmë' dhe rrëfimi i nënës
4 Uragani Ian 'pushton' Floridën, 2 milionë qytetarë pa energji elektrike! Gjendje e jashtëzakonshme brenda vendit
5 Beteja me ndërtimet pa leje/ Vendimi: Mbikëqyrës për çdo ndërtues, do raportojë brenda 5 ditëve shkeljen e lejes dhe shtesat e kateve




Kronikë

# Të shtëna me armë zjarri në Pukë, vdes 44-vjeçari! U dërgua në spital nga dy persona të paidentifikuar, ndërroi jetë në sallën e operimit (EMRI)

*Një 44-vjeçar është ekzekutuar mbrëmjen e kësaj të marte në Pukë. Report Tv ka mësuar se ka ndërruar jetë Pjetër Kola 44-vjeç, nga Lezha.*

Redaksia
27 Shtator, 21:20 | **Përditesimi: 27 Shtator, 23:06**

**PUKË**- Një 44-vjeçar është ekzekutuar mbrëmjen e kësaj të marte në Pukë. Report Tv ka mësuar se ka ndërruar jetë Pjetër Kola 44-vjeç, nga Lezha.

Ngjarja ka ndodhur rreth orës 18:00, në fshatin Qafë Çelë, në rrethana ende të paqarta. Mësohet se 44-vjeçari është dërguar në qendrën shëndetësore të Vaut të Dejës nga 2 persona ende të panjohur, por gjendja e tij shëndetësore u përkeqësua për pasojë u dërgua me urgjencë në Spitalin Rajonal Shkodër. Ai kishte marrë një plumb në bark dhe iu nënshtrua një ndërhyrje kirurgjikale, por nuk ia doli të mbijetonte.


LEXO EDHE:
**Shkodër/ Mashtronin përmes bursës, në pranga administratori dhe menaxherja në një Call Center, 7 operatorë nën hetim! Arrestohen dhe 3 specialistët e teknologjisë**

Është ngritur menjëherë grupi hetimor dhe nën drejtimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër vijon puna për zbardhjen e rrethanave të ngjarjes, identifikimin dhe kapjen e autorit/ve.

**Rendit zhvillimet sipas orarit:** Të Fundit

**Ora 21:57**

## U plagos sot në Shkodër, ndërron jetë 44-vjeçari në sallën e operacionit




Ka ndërruar jetë 44-vjeçari, Pjetër Kola, i cili u plagos mbrëmjen e sotme në Shkodër. Report Tv ka mësuar se ai ka ndërruar jetë gajtë operacionit.

> *"Rreth orës 18:00, në qendrën shëndetësore të Vaut të Dejës është paraqitur për ndihmë mjekësore, shtetasi P. K., 44 vjeç,  nga Lezha,  i plagosur me armë zjarri, në rrethana ende të paqarta, ne fshatin Qafë Çelë, Pukë.  Ky shtetas është transportuar në Spitalin Rajonal Shkodër, për ndihmë mjekësore më të specializuar, i cili ndërroi jetë në spitalin e Shkodrës. Është ngritur menjëherë grupi hetimor dhe nën drejtimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër vijon puna për zbardhjen e rrethanave të ngjarjes, identifikimin dhe kapjen e autorit/ve", njofton policia.*

**Ora 21:25**

## U plagos sot në Shkodër, Report Tv zbardh emrin, kush është 44-vjeçari që u qëllua me armë

Report Tv ka zbardhur emrin e personit që mbeti i plagosur në Shkodër. Ai është Pjeter Kola 44-vjeç.

B.K./Shqiptarja.com

TAG: pjeter kola | Shkoder | vrasja e pjeter koles

Komento

### Komente

**Mario:** 27/09/2022 22:01
Si nuk u ben nje here njerez keta, vazhdojne akoma me hakkmarrje.
**Përgjigju**

**Anonim:** 27/09/2022 23:17
KAN PER TE NGEL INJORANT DHE PER 1 SHEKULL .

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:**
**A mendoni se vendosja e fashës 800 kWh do të sjellë kursim të energjisë?**

Po | Jo | Nuk e di

## Lajme të tjera

Politikë

Denoncon 'Rithemelimi': Korrupsion në shkollën profesionale në Shkodër, paratë shkojnë në xhepat e zyrtarëve të bashkisë së Vaut të Dejës
28 Shtator, 12:25

Kronikë

Konflikti për parcelën e kanabisit, vritet 44-vjeçari në Pukë! Shpallet në kërkim Maltin Gjini, e qëlloi me plumb në bark
28 Shtator, 08:41

Politikë

Mungesa e socialistëve, dështon mbledhja e këshillit bashkiak në Shkodër, ministrja Bilali 'dush të ftohtë' këshilltarëve të PS: Kulm i jo njerëzores
27 Shtator, 13:04

Sociale

Moti i keq në Qarkun e Shkodrës, Emergjencat Civile: Dëme në ura, rrugë e kanale vaditëse
27 Shtator, 09:35

Sociale

Reshjet e shiut në Pukë, prurjet e përrenjve dëmtojnë urat që lidhin fshatrat! Kryebashkiaku: Situata është e vështirë
27 Shtator, 08:40

Kronikë

Moti i keq në Shkodër, prurjet e lumenjve dëmtojnë urën që lidh 2 fshatrat
26 Shtator, 18:02

Kultura

15 vjet nga ndarja nga jeta e françeskanit At Zef Pllumit
25 Shtator, 21:15

Kronikë

Aksident në aksin Shkodër-Hani i Hotit, plagosen rëndë dy persona! Një nga drejtuesit është oficer policie
24 Shtator, 21:30

Kronikë

Në kërkim, por mori hakun e babait! Djali i Ismet Çekorjes të ekzekutuar në 2 shtator vrau 19-vjeçarin në Shkodër për hakmarrje
22 Shtator, 18:32



© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje